



Pilot Njësia Komunale Junik

Kuvendi i Pilot Njësisë Komunale ne Junik, Në bazë të rregullores 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave te Kosovës, nenit 11 nen 11.2 dhe nenit 30.2 te Statutit te PNJK-së Junik,në mbledhjen e vet të mbajtur më 31.07. 2006 miraton këtë:

RREGULLORE PËR PUNËN E KUVENDIT TË PNJK-JUNIK

Neni 1.

Me këtë Rregullore rregullohet procedura e konvokimit te seancave të Kuvendit, ecuria, diskutimet, votimet, të drejtat e delegatëve ,udhëheqësve te grupeve kuvendare dhe masat për funksionimin normal te mbledhjeve te kuvendit te PNJK në Junik.

Neni 2.

Referimi në komitete,gjegjësisht -komisione me këto rregulla do të thotë referim ne nënkomitete dhe nënkomisione.

Neni 3.

Në rast se rregullat e kësaj rregulloreje janë në kundërshtim me rregullat e Rregullores 2000/45 dhe statutin,atëherë zbatohen këto te fundit.

Neni 4.

Kuvendi i PNJK-së dhe komisionet e tija do të trajtojnë vetëm çështje te cilat bien në kompetencë të PNJK-së. Veçmas kur ato ndryshojnë sipas kërkesës se pushtetit qendror dhe me kërkesën e tyre.

Neni 5.

Anëtari, pjesëmarrës ne mbledhjen e Kuvendit, duhet të shënoj emrin e tij/sajë në librin e pjesëmarrësve apo në listën e të pranishmëve destinuar për këtë qellim.

Mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme te Kuvendit të PNJK-së dhe Komiteteve të tij.

Neni 6.

Kuvendi i mban mbledhjet e rregullta ashtu sikurse e parasheh neni 33 i statutit të PNJK-së.

Kur është fjala për kuorumin e mbledhjes dhe mënyrës së votimit në kuvendin e PNJK- së, përshtatet dhe aplikohet dispozita e nenit 32 të statutit të PNJK-Junik.

Neni 7.

Mbledhjet e rregullta te Kuvendit i thërret dhe i kryeson Kryetari i Kuvendit, deputetet duhet të njoftohen me kohën,datën , vendin e mbledhjes dhe agjendën e mbledhjes,së paku 7 ditë pune para çdo mbledhjeje e në raste urgjente 3 ditë.

Orari i mbajtjes së mbledhjeve të rregullta për vitin vijues caktohet në mbledhjen e fundit të vitit kalendarik.

Mbledhjet e komitetit për politikë dhe financa i thërret dhe kryeson Kryetari i Kuvendit.

Neni 8.

Mbledhjet e jashtëzakonshme i thërret dhe kryeson në çdo kohë Kryetari i Kuvendit gjersa kryesuesi i Komitetit në çdo kohë i thëret mbledhjet e jashtëzakonshme të Komitetit.

Neni 9.

Thirrja e mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme të kuvendit dhe Komiteteve të tija bëhet konform dispozitave të rregullores mbi vetëqeverisjen e Komunave 2000/45 dhe statutit të PNJK-së

Neni 10.

Në mungesë të Kryetarit ose kryesuesit, kur ata janë të penguar (sëmundje, udhëtim zyrtar etj) mbledhjet i thërret dhe i kryesojnë zëvendësit e tyre, e nëse edhe kryesuesi është i penguar, mbledhjet i thërret Drejtori Ekzekutiv dhe i kryeson anëtari më i moshuar prezent.

Neni 11.

Neni 15.3 i rregullores mbi vetëqeverisjen lokale aplikohet përshtatshmërisht për mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve. Drejtori Ekzekutiv apo i autorizuari i tij garanton se janë përmbushur kushtet për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit e të Komiteteve.

Drejtori Ekzekutiv, apo i autorizuari i tij, në tabelën e publikimeve të zyrave kryesore publikon njoftimin mbi kohën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes dhe duhet të garantojë se janë përmbushur kushtet për mbajtjen e mbledhjeve të Asamblesë dhe komiteteve, si dhe të dorëzojë ftesat për pjesëmarrje në mbledhje çdo anëtar të kuvendit-komitetit së bashku me agjendën e punës që do të diskutohet në mbledhje.

Neni 12.

Kur është fjala për mbledhjen e parë inauguruese dhe betimin përshtatshmërisht aplikohet dispozita e nenit 12.1 dhe 12.2 e rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave 2000/45.

Neni 13.

Në mbledhje të rregullta të kuvendit, mund të merr pjesë publiku pa ndonjë kufizim përpos kufizimeve hapësinore.

Nëse interesimi i publikut për pjesëmarrje në mbledhje është shumë i madh në raport me mundësit hapësinore, pjesëmarrësit (publiku) caktojnë përfaqësuesin e tyre që të bëjë ujdi me kryesuesin e mbledhjes për numrin e publikut që do të merr pjesë në mbledhje. Pjesëtarët e publikut (të përgjithësuar) nga alineja një e këtij neni mund të marrin fjalën në mbledhje dhe jo më gjatë se 30 minuta dhe atë para fillimit të çështjeve tjera të mbledhjes.

Kryesuesi i mbledhjes vendos për rendin me të cilin pjesëtari i publikut mund të ju drejtohet pjesëmarrësve në mbledhje, si dhe duhet ta ndërpres atë nëse fjalimi i tij është më i gjatë dhe gjërat përsëriten..

Neni 14.

Delegatët e njoftuar,në pajtim me nenin 7 të kësaj rregulloreje,bashkë me agjendën e punës, të përgatitur nga Kryetari i Kuvendit dhe Drejtori Ekzekutiv,marrin materialet diskutuese - procesverbalet nga mbledhjet paraprake të Kuvendit.

Neni 15.

Rendi i punës ne mbledhje do të jetë zakonisht me sa vijon:

- a) arsyetim për mos pjesëmarrje në mbledhje
- b) delegim dhe pjesëmarrje e publikut,
- c) miratim i procesverbalit nga mbledhja e fundit,
- d) peticione(shkrime)për te cilën mbledhje është paraparë të diskutohen,
- e) punët për te cilat i ngarkon rregullorja,statuti dhe ligji në fuqi,
- f) çështjet e sjellura nga kryesuesi i mbledhjes dhe temat që lindin aty,
- g) Puna e pa përfunduar në takimin e fundit,
- h) raporte dhe rekomandime të pranuar nga komitetet dhe çështjet e lindura si rezultat i raporteve,
- i) raportet dhe rekomandimet e marra nga Drejtori Ekzekutiv dhe bordi i drejtorëve dhe çështjet e lindura si rezultat i këtyre raporteve ,
- j) çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetin e komunës dhe të shtruar nga anëtarët sipas rendit se si janë pranuar
- k) dhe propozime nga anëtarët sipas radhës se pranimit,si dhe
- l) të ndryshme që sipas mendimit të kryesuesit meritojnë trajtim në mbledhje

Neni 16.

Gjatë mbledhjes mund të vendoset të punohet me rend pune të ndryshuar

Neni 17.

Kur rendi i ditës përgatitet nga shërbimi profesional i Drejtorit Ekzekutiv duhet:

- a) ti dërgojë secilit anëtar nga një kopje të dokumentacionit që përmban shënime lidhur me çështjet që duhet të trajtohen në mbledhje.
- b) ose ti njoftoj anëtarët se dokumenti është i gatshëm për inspektim dhe ta bëj atë dokument të gatshëm për shqyrtim nga anëtarët gjatë orarit të rregullt të punës.

Neni 18.

Drejtori Ekzekutiv,atëherë kur rendi i ditës ti jetë dorëzuar për inspektim të publikut,duhet publikisht të njoftoj mbi atë se kopja e çfarëdo dokumenti që është pronë e komunës e që përmban shënime mbi çfarëdo çështje që do të shtrohet në mbledhje, mund të inspektohet nga pjesëmarrësit e publikut gjatë orarit të rregullt të punës.

Neni 19.

E drejta e inspektimit e përcaktuar me nenin 17,nuk vlen për te gjitha dokumentet sipas seksionit 7.3 te rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës ose për çfarëdo dokumenti i cili sipas mendimit te Drejtorit Ekzekutiv ka të bëjë me çështje që duhet të diskutohen në mbledhje pa pjesëmarrjen e publikut ashtu siç është përcaktuar në seksionin 7.4 te rregullores së lart përmendur.

Rregullat e debatit.

Neni 20.

Propozimi nuk mund të diskutohet para se i njëjti të shtrohet dhe të përkrahet në mbledhje.

Neni 21.

Kur bëhen ndryshime ,propozimi i ndryshuar zë vendin e propozimit të parë dhe shëndrrohet në propozim të rregullt ndaj të cilit mund të propozohen ndryshime të tjera.

Neni 22.

Nëse dy ose më shumë anëtarë dëshirojnë të marrin fjalën,kryesuesi i mbledhjes vendos për renditjen,dhënien e fjalës. Anëtarët i drejtohen kryesuesit te mbledhjes dhe gjate fjalimit te tyre duhet ti përmbahen çështjeve aktuale te mbledhjes.

Neni 23

Anëtarët mundë të kërkojnë të flasin sipas renditjes dhe fjalimi i tyre duhet të dëgjohet dhe të mbahet qetësi deri në përfundimin e fjalimit të tyre. Vendimi i kryesuesit mbi pikat e renditura ose mbi pranueshmërinë e shpjegimeve personale është përfundimtar

Neni 24.

Diskutimet mundë të zgjasin gjerë në 5 minuta me përjashtim të referuesve.

Neni 25.

Askush nuk ka të drejtën të diskutojë më tepër se një herë për të njëjtën çështje,me përjashtim të sqarimeve plotësues.

Neni 26.

Partitë pjesëmarrëse në Kuvend caktojnë udhëheqësin e grupit ,i cili jep propozime në emër të partisë së cilës i takon në Kuvend. Këtë mund ta bëjnë edhe këshilltarët në mënyrë individuale.

Neni 27.

Udhëheqësit e grupeve,përkatësisht të autorizuarit e tyre si dhe këshilltarët në mënyrë individuale kanë të drejtë të kërkojnë pauzë për konsultime me kohëzgjatje 10 gjer në 20 minuta gjatë seancës se kuvendit.

Neni 28.

Personat e cekur ne nenin 27 te kësaj rregullore kane te drejtë që të kërkojnë pauzë sipas nevojës se paraqitur.

Neni 29.

Kur një propozim i dhënë është duke u diskutuar, nuk lejohet bërja e propozimeve te tjera,përveç

- a)propozimit për ndryshime,
- b)propozimi i bërë për të parandaluar çrregullimet,
- c)propozimi për të përjashtuar publikun dhe shtypin,duke u bazuar në seksionin 7.4 te rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave te Kosovës,
- d)propozimi për të kaluar ne pikën e radhës të rendit te ditës,
- e)propozimi qe kërkon që çështja në diskutim të mbyllet në mbledhje me marrjen e vendimit.

- f)propozimi për të shtyrë diskutimin e çështjes së shtruar për mbledhjen e ardhshme,
- g)propozimi për ndërprerjen e mbledhjes.

Neni 30.

Kryesuesi nuk do të lejojë asnjë propozim të ri gjatë mbledhjes sipas kësaj rregulloreje neni 29(d)ose(e), derisa të gjithë që dëshirojnë të marrin fjalën –mendimin tu ofrohet kohë e mjaftueshme për këtë.

Neni 31.

Kur ndonjë anëtarë e ka fjalën në mbledhje, të gjithë anëtarët tjerë pjesëmarrës qëndrojnë ulur. Nëse kryesuesi i mbledhjes qëndron në këmbë gjatë debatit të gjithë anëtarët tjerë duhet të ulen dhe të heshtin.

Neni 32.

Nëse ndonjë anëtar jep propozim ai ka të drejt të marr përgjigjen menjëherë nëse është e mundur para se propozimi ti nënshtrohet votimit.

Neni 33.

Gjatë gjithë kohës së zgjatjes së mbledhjes,kryesuesi duhet ta respektoj parimin, që të gjithë anëtarët pjesëmarrës dhe me të drejtë fjalimi, të gëzojnë të drejtën e barabartë dhe të kenë rastin që të marrin pjesë aktivisht në mbledhje.

Neni 34.

Për replikë ka të drejtë vetëm personi,emri i të cilit përmendët gjatë diskutimit,dhe se replika zgjat më së shumti 2 minuta.

VOTIMI

Neni 35.

Votimi bëhet në pajtim me rregulloren mbi vetëqeverisjen e komunave 2000/45 dhe statutin e PNJK.

Neni 36.

Vendimet merren me shumicën e votave të delegateve prezent,nëse nuk parashihet ndryshe me rregulloren mbi vetëqeverisjen e komunave 2000/45, apo Statutin e Komunës.

Neni 37.

Anëtarët prezent dhe atë secili, ka të drejtë të kërkojë që ti lexohet procesverbali i mbledhjes,ku shihet se ai/ajo ka votuar apo nuk ka votuar për çështjen e caktuar ose ka abstenuar.

Neni 38.

Kur votohet për propozimin për emërimin-zgjedhjen e ndonjë kandidati në ndonjë pozitë në Kuvend,dhe kur ekzistojnë dy apo më shumë kandidat të propozuar,emrat e të propozuarve paraqiten sipas radhës alfabetike të mbiemrave të tyre.

Neni 39.

Kur votohet fshehët,për propozimin si në nenin 38 të kësaj rregulloreje Drejtori Ekzekutiv i shpërndan fletë votimet anëtareve më të drejtë vote. Fletë votimi përmban emrat e të gjithë kandidateve të renditur sipas alfabetit e bazuar në mbiemrat e tyre.

Drejtori Ekzekutiv po ashtu siguron dhe kutit e votimeve.

Votohet, në mbledhje, duke shënuar "X" afër emrit të kandidatit për të cilin dëshiron të votoj, e më pas flet votimi hedhet në kutin e votimeve, ku pas përfundimit të votimit Drejtori Ekzekutiv bën publikisht numërimin e votave dhe më pas gjatë mbledhjes konfirmon rezultatin e votimit. Fletëvotimet më pas nga Drejtori Ekzekutiv ruhen në një vend të sigurt për një periudhë 12 muajsh nga dita e përfundimit të votimit.

Neni 40.

Nëse gjatë zhvillimit të mbledhjes ndonjë nga anëtarët nuk sillet mirë dhe pengon punën në mbledhje e duke mos respektuar urdhëratë me dashje apo duke u sjellur në mënyrë ofenduese, atij/asaj kryesuesi paraprakisht ia tërheqë vërejtjen e më pas nëse sjelljet e atij/asaj janë të pa përmirësueshme kryesuesi i propozon Kuvendit shqiptimin e këtyre masave, më sa vijon:

- a) Që anëtari të mos dëgjohet, e nëse propozimi i kryesuesit aprovohet anëtarit i ndalohet fjalimi i mëtutjeshëm në mbledhje.
- b) Të urdhërohet tërheqja e tërësishme apo pjesëshme nga pjesa e mbetur e mbledhjes, përpos kur do të ketë votim.
- c) Të jepet urdhër që anëtari të largohet nga mbledhja, përpos rastit kur aji/ajo duhet të votojë.
- d) Të shtyhet mbledhja për një orë apo të ndërpritet mbledhja, ku Kuvendarët për kohën, datën, vendin e mbajtjes së mbledhjes informohen në kohë.

Neni 41.

Nëse pjesëtari i publikut me dashje pengon punën e mbledhjes, kryesuesi atij/asaj ia tërheqë vërejtjen e nëse prap edhe përkundër kësaj vazhdon të pengoj mbledhjen kryesuesi i propozon kuvendarëve shqiptimin e këtyre masave me sa vijon:

- a) tërheqjen e tërësishme ose të pjesëshme nga mbledhja,
- b) largim nga mbledhja.

Neni 42.

Nëse mbledhja ndërpritet për ndonjë çrregullim të madh, kryesuesi mund të shtynë mbledhjen dhe për mbledhjen e ardhshme kuvendarët njoftohen më kohë.

Neni 43.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregullore bëhen sipas procedurës së miratimit të së njëjtës përmes kuvendit.

Neni 44.

Rregullorja hyn në fuqi ditën e miratimit në Asamblenë Komunale.

KUVENDI I PËRKOSHËM I PNJK-JUNIK

**Junik
01.08.2006.**

**Kryetari i PNJK-Junik
Tahir Isufaj**
